



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 6589 / Prot. 3

Tiranë, më 21 . 11 . 2023

UDHËZIM

Nr. 23 , datë 21 . 11 . 2023

PËR
PËRCAKTIMIN E VEPRAVE PENALE QË PËRBËJNË NDALIM PËR TË
PUNUAR NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të shkronjës "c" të nenit 60/1 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Punonjësi arsimor, si dhe çdo punonjës tjetër i sistemit arsimor, që punon me fëmijët, nuk mund të punësohet dhe, kur është i punësuar, përfundon marrëdhënien e punës në rast se është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që, për shkak të natyrës së veprës së kryer, diskrediton pozitën dhe figurën e punonjësit arsimor ose dëmton rëndë besimin e publikut në sistemin arsimor, pavarësisht nëse është rehabilituar sipas parashikimeve të Kodit Penal.
2. Në kuptim të pikës 1, të këtij udhëzimi përbën ndalim për të punuar në sistemin arsimor parauniversitar dënimi me vendim gjykatë të formës së prerë për veprat penale të parashikuara nga nenet 73, 74, 74/a, 75, 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a 79/b, 79/c, 81, 86, 87, 88, 89/a, 99, 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 106, 107/a, 108, 108/a, 109, 109/b, 109/c, paragrafi i dytë i nenit 110, 110/a, 110/b 110/c, 111, 113, 114, 117, 124, 124/b, 128/b, 129, 130/a, 135, 136, 139, 140, 141, 186/a, 187, 218, 219 220, 221, 222, 230, 230/a, 230/b, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 244, 245, 245/1, 259, 283, 283/a, 283/b, 284, 284/a, 286, 286/a, 333, 333/a 334 të ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar institucionet

arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

OGERTA MANASTIRLIU



A V Z
dhy